

VENDIM
Nr. 769, datë 12.11.2014

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË
DREJTËSISË TË PASURISË SË PALUAJTSHME, TË NDODHUR NË ZONËN
KADASTRALE NR. 8380, ME NUMËR PASURIE 6/145, PËR GJYKATËN
KUSHTETUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 14, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë të pasurisë së paluajtshme, të ndodhur në zonën kadastrale nr. 8380, me numër pasurie 6/145, me sipërfaqe trualli 859 (tetëqind e pesëdhjetë e nëntë) m², me sipërfaqe ndërtimi 518 (pesëqind e tetëmbëdhjetë) m², me adresë: rruga “Reshit Çollaku”, Tiranë, në funksion të akomodimit të Gjykatës Kushtetuese, sipas kartelës dhe planvendosjes që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Objekti i sipërpërmendur të përdoret në funksion të qëllimit dhe të veprimtarisë së Gjykatës Kushtetuese.

3. Ministria e Drejtësisë nuk mund ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi dhe as ta tjetërsojë atë.

4. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Gjykata Kushtetuese dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**D - SEKSIONI I QIRAVE, NË PËRDORIM, MARREVESHJEVE KUFIZUESE,
SERVITUTAVE DHE INTERESAVE TE TJERA**

Nr. Dok	Data e Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. të Çertifikatës	Shënime	Firma

E - SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TE GJYKATES, KUFIZIMEVE, etj.

Nr. Dok	Data e Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. të Çertifikatës	Shënime	Firma

